



Programi i lëndës: “Organizimi i punës dhe detyrat e teknikut të farmacisë në sektorin farmaceutik”	
Lëmi	Shëndetësi
Profili	Farmaci
Niveli	I
Klasa	Klasa 10
Fondi i orëve të lëndës:	35 javë x 2 orë/javë = 70 orë
Programi i hollësishëm i lëndës	
Kapitulli I: Historiku i zhvillimit të farmacisë	
a) Qëllimet e kapitullit	
Në përfundim të kapitullit nxënësit duhet të: <ul style="list-style-type: none">- dallojë obligimet e institucioneve shëndetësore- përshkruajë rëndësinë e farmacisë si shkencë, në kuadër të shkencave mjekësore- përshkruajnë detyrat themelore të farmacisë;- shpjegojnë historikun e zhvillimit të mjekësisë - farmacisë;- përshkruajnë historikun e zhvillimit të farmacisë në Kosovë;	
b) Temat e kapitullit	
<ul style="list-style-type: none">- Farmacia si degë e shkencave mjekësore- Detyrat themelore të farmacisë- Historiku i zhvillimit të mjekësisë - farmacisë- Historiku i zhvillimit të farmacisë në Kosovë- Historiku i zhvillimit të farmacisë në vendet tjera.	
c) Udhëzime didaktike për kapitullin	
Rekomandohet që mësuesi të: <ul style="list-style-type: none">- ilustrojë me anë të figurave dhe të vizatimeve sa është e mundur temat e kapitullit;- përcjellë me kujdes përparimin e nxënësve gjatë shpjegimit;- nxisë aftësitë dalluese të nxënësve me punë në grupe;- organizojë detyra teorike të cilat duhet zgjidhur nga ana e nxënësve- shpjegojë përmes shembujve të ndryshëm nga jeta e përditëshme;- nxisë aftësitë dalluese të nxënësve me punë në grupe;- përdor pyetje- përgjigje me gojë për të kontrolluar ecurinë e të kuptuarit të nxënësve;- organizojë testim me shkrim për vlerësimin e nxënësve duke përdorur pyetje të kombinuara.	
d) Kushtet për realizimin e kapitullit	
<ul style="list-style-type: none">- Aspektet teorike të trajtohen në klasë mësimore- Mjetet mësimore- CD-programe	
Kapitulli II: Organizimi i dhe legjislacioni farmaceutik	

a) Qëllimet e kapitullit
Në përfundim të kapitullit nxënësit duhet të: - përshkruajë rregulloren mbi barnat - shpjegojë rregulloren mbi prodhimin e barnave - shpjegojnë obligimet e institucioneve farmaceutike dhe organizimin e punës në to. - Përdor literaturën farmaceutike, gjuhën standarde, nomenklaturën dhe simbolet në farmaci - zbatojë legjislacionin farmaceutik
b) Temat e kapitullit
- Organizimi i shërbimit farmaceutik - Institucionet farmaceutike dhe organizimi i punës në këto institucione - Rregullorja mbi prodhimin e barnave - Literatura farmaceutike, farmakopea, standardi shtetëror, formulari farmaceutik - Receta - rregullat e leximit të saj. - Gjuha standarte, nomenklatura dhe simbolet e farmacisë
c) Udhëzime didaktike për kapitullin
Rekomandohet që mësuesi të: - përcjellë me kujdes përparimin e nxënësve gjatë shpjegimit; - nxisë aftësitë dalluese të nxënësve me punë në grupe; - bëjë demonstrim konkret për këtë kapitull - organizojë detyra teorike të cilat duhet zgjidhur nga ana e nxënësve - angazhojë nxënësit në punë konkrete për përdorimin e literaturës
d) Kushtet për realizimin e kapitullit:
Mjetet mësimore CD-programe Literaturë farmaceutike Receta –për demonstrim
Kapitulli III: Organizimi i vendit të punës në industrinë farmaceutike
a) Qëllimet e kapitullit
Në përfundim të kapitullit nxënësit duhet të: - të interpretojë drejt mjediset e punës në industrinë farmaceutike - të zbatojë kriteret themelore për higjienë dhe siguri personale në industrinë farmaceutike - të dallojë mjetet, pajisjet dhe aparaturat e punës në mjedisin e prodhimit - të dallojë mjetet, pajisjet dhe aparaturat e punës në depon e industrisë farmaceutike - të dallojë mjetet, pajisjet dhe aparaturat e punës në laboratorin farmaceutik - të zbatojë rregullat e miëmbajtjes së pastërtisë dhe përdorimit të enëve dhe aparaturve në laboratorin e industrisë farmaceutike.
b) Temat e kapitullit
- Mjediset e punës në industrinë farmaceutike - Higjiena dhe siguria personale dhe e mjedisit të punës në industrinë farmaceutike - Ndërtimi hapsinor, mjetet dhe pajisjet në mjedisin e prodhimit - Ndërtimi hapsinor, mjetet dhe pajisjet në depon e industrisë farmaceutike - Ndërtimi hapsinor, mjetet dhe pajisjet në laboratorin farmaceutik të industrisë farmaceutike
c) Udhëzime didaktike për kapitullin
Rekomandohet që mësuesi të: - ilustrujë me anë të figurave dhe të vizatimeve sa është e mundur temat e kapitullit; - përcjellë me kujdes përparimin e nxënësve gjatë shpjegimit;

- nxisë aftësitë dalluese të nxënësve me punë në grupe;
d) Kushtet për realizimin e kapitullit:
- Aspektet teorike të trajtohen në klasë mësimore - Mjetet mësimore - CD-programe - Video-projektor
Kapitulli IV: Organizimi i vendit të punës në barnatore si institucion mjekësor i shërbimit farmaceutik
a) Qëllimet e kapitullit
Në përfundim të kapitullit nxënësit duhet të: - Perkufizojë barnat, format farmaceutike - Dallojë barnat e klasifikuara sipas kriterëve të ndryshme - përshkruajë barnatoren dhe detyrat e saj - shpjegojë pjesët përbërëse të barnatores - të respektojë rregullat e rradhitjes dhe ruajtjes së barnave në barnatore - të respektojë mënyrën e dhënies së barnave në barnatore - të përzgjedhë mjetet për punë në barnatore
b) Temat e kapitullit
- Barnat, format farmaceutike - Klasifikimi i barnave - Barnatorja – roli dhe detyrat e saj - Modele të farmacive në vendet e bashkimit evropian - Pjesët përbërëse të barnatores - Radhitja e barnave në barnatore - Ruajtja e barnave në barnatore - Mënyra e dhënies së barnave në barnatore - Shitja e barnave dhe kimikateve që mund të ipen pa recetë - Dozimi i barnave në barnatore - Mjetet për punë në barnatore
d) Kushtet për realizimin e kapitullit:
- Aspektet teorike të trajtohen në klasë mësimore - Veprimtaritë praktike duhet të kryhen në grupe të vogla prej 4-5 nxënësish. - Gjatë shpjegimit të mësimi duhet të përdoren medie didaktike si videoprojektorë